

Gjuha e mediave dhe disa shkarje kuptimore, II

Sami ISLAMI

1 mars 2012

Përmbledhje

Në këtë shkrim të shkurtër autori ka vënë në spikamë disa raste të përdorimit jo të drejtë të trajtave emërore, të përdorura gabimisht në ligjërimet e mediave tona të shkruara dhe elektronike, të cilat ai (autori) me të drejtë i ka konsideruar si shkarje kuptimore, sepse bien ndesh me rregullat leksiko-gramatikore të gjuhës sonë.

Njëra nga fushat që, gjithsesi, ndikon në ndërgjegjësimin gjuhësor të profileve të ndryshme shoqërore, padyshim janë mediat. Me media secili nga ne është në kontakt gjatë gjithë ditës: si me ato të shkruara, gazetat ditore ose periodike, revistat, po ashtu edhe me mediat elektronike, televizioni, radioja, interneti etj. Të gjitha ngjarjet që ndodhin në vend a në botë, si dhe të gjitha aktivitetet e tjera nga fusha e kulturës, shkencës, sportit etj. transmetohen te lexuesi apo dëgjuesi kryesisht nëpërmes gjuhës. Së këndejmi pra, kur jemi te gjuha, mund të bëhet pyetja: Sa jemi kritik për atë se si po e flasim, apo po e shkruajmë atë? Kjo çështje në rend të parë i vë në përgjegjësi njerëzit që direkt apo indirekt merren me gjuhë. Nuk mjafton që me gjuhë të merren vetëm gjuhëtarët, siç, ndoshta, mund të mendojë ndokush. Gjuha është e të gjithëve, apo jo? Duke e pasur parasysh, mungesën e një ndërgjegjësimi jo të mjaftueshëm gjuhësor të kësaj kategorie intelektualësh, gabime të tilla në mediat tona, po dalin për ditë e më shumë. Kësaj radhe, mendoj, se ia vlen të preken vetëm disa probleme të kësaj natyre. Të shkojmë me radhë!

Shpesh na ka rënë t'i dëgjojmë, apo t'i shohim të shkruara konstruktet, si: *Një qift bashkëshortor e adaptoi një fëmijë. Në jetimore presin për t'u adaptuar edhe shumë fëmijë të tjerë*, etj. A e dijnë ata (në rend të parë gazetarët, por edhe të tjerët, si lektorët, redaktorët etj.) domethënien e kësaj fjale? A konsultohet mjaft fjalori (edhe pse edhe për Fjalorin e Gjuhës Shqipe ka çfarë të thuhet, sigurisht edhe për mungesat e tij)? Megjithatë le të shohim se ç'thotë ai? **Fjalori i Gjuhës Shqipe**, Tiranë, 2006, f. 26 jep këtë shpjegim: **ADAPT/OJ**, kal. -OVA, -UAR, *përdorim librar PËRSHTAT. Pra, përshtat një dhomë për ta bërë klasë, ose përshtat një tekst për një nivel arsimit të caktuar etj. etj.* Nga kjo del qartë se fjala që do të duhej të përdorej për të shprehur kuptimin që e përmendëm më lart nuk është *ADAPTOJ*, por është **ADOPTOJ**. Nga lat. ADOPTARE që do të thotë "marr një fëmijë të huaj dhe e bëj si timin" (shih: Kljaic,

B., Veliki rjecnik stranih rijeci i izraza i kratica, Zora, Zagreb, 1974., f. 14). Së këndejmi shembujt që i morëm në shqyrtim do të duhej të dilnin kështu: Një qift bashkëshortor adoptoi një fëmijë. Dhe: *Në jetimore presin për t'u adoptuar edhe shumë fëmijë të tjerë*, por jo: "Në jetimore presin për t'u adoptuar edhe shumë fëmijë të tjerë", etj.

Nuk janë raste të rralla kur mund të haset në përdorim të gabuar edhe fjala **BIRËSOJ** (folje), **BIRËSIM** (emër), **BIRËSUAR** (mbiemër), në kuptimin e **adoptimit**. Po këtu është një problem tjetër, se fjala (folja) **BIRËSOJ** po përdoret gabimisht edhe atëherë kur ka të bëjë me fëmijën e gjinisë femërore. Dihet se fjala **BIRËSOJ** vjen nga fjala **BIR** (i biri) që normalisht i referohet një fëmije të gjinisë mashkullore. Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, 2002, fjala **BIRËSOJ** përdoret edhe kur është fjala për adoptimin si të një djali, po ashtu edhe apo të një vajze! P. sh. *Një qift e birësoi një djalë*, por edhe: *Një qift e birësoi një vajzë!* Pra nëse "**birësoj**" përdoret kur adoptohet një fëmijë i gjinisë mashkullore, kur kemi të bëjmë me fëmijë të gjinisë femërore, duhet të përdoret fjala "**bijësoj**" (pra nga "**bijë**"). Së këndejmi mund të konstatohet se konstrukti i drejtë do të duhej të ishte "*Qifti e BIJËSOI një vajzë. Por jo*" e **BIRËSOI** një vajzë!". Fjalën **BIJËSOJ** do ta gjejmë në **Fjalorin e Gjuhës Shqipe** (botim i vitit 2006, f. 91), por jo edhe në botimet e mëhershme. Në Fjalor gjejmë këtë shpjegim: *Bijësoj, e bëj bijë në shpirt, bijoj.*

Një çështje tjetër që, ndoshta, vlen të shqyrtohet këtu është edhe ngatërrimi kuptimor (semantik) i fjalëve "dëshmor" dhe "martir" (nga greqishtja "martyros" flijues, dëshmor etj., sipas Kljaic, B., f. 815). Duke mos e ditur, ndoshta se këto dy fjalë janë sinonime, shpesh ngatërrohen. Më ka rënë t'i dëgjoj në RTK, në RTV 21, e gjetiu këto dy fjalë në konstrukte si: *Varrezat e dëshmorëve dhe të martirëve i vizitoi një delegacion shtetëror. Në varrezat e dëshmorëve dhe martirëve do të mbahet një përkujtim rasti. Ose edhe më paradoksale: Sot u përkujtuam 5 dëshmorë dhe katër martirë!* etj. Dihet mirëfilli se, ashtu siç i kemi fjalët (sinonimet) *djalë- çun, vajzë-gocë, fëmijë-kalama* etj, po ashtu kemi edhe sinonimet "**dëshmor**" dhe "**martir**". Dhe kur jemi këtu, është e natyrshme se shembujt që i morëm në shqyrtim do të duhej të përdoreshin me njëren apo tjetrën fjalë, ose edhe me të dyjat por pa lidhëzat *e, edhe, dhe*. Se vetë përdorimi i këtyre lidhësave del sikur këto dy fjalë janë të ndryshme kuptimisht e jo sinonime. Krejt në rregull do të ishte sikur në mes të këtyre fjalëve të përdoreshin lidhëzat veçuese *ose, a, apo*. Në këto raste kuptimi i fjalisë mbetet i njejtë, por i shprehur me një një sinonim tjetër. P. sh: **Varrezat e dëshmorëve (ose të martirëve) i vizitoi një delegacion shtetëror". Në varrezat e dëshmorëve (ose martirëve) do të mbahet një përkujtim rasti**, etj. Nëse fjalia që sapo e cituam do të mund të merrej si e "e rregullt", atëherë formulime "të rregullta" do të mund të quheshin edhe konstruktet: *Disa djem dhe çuna po luanin në oborr!*, ose: *Pesë vajza e dy goca jetojnë në të njejtin pallat!* etj.

Një tjetër fjalë që na bie shpesh ta dëgjojmë, ose ta shohim të shkruar është edhe emri "**viktimë-a**". Edhe kjo fjalë shpesh po përdoret me kuptim të gabuar. Krejt është në rregull nëse kjo fjalë përdoret në konstrukte të tilla, si: *Këto ishin viktima të tërmetit* (nëse dikush humb jetën apo lëndohet nga kjo fatëkeqësi natyrore), ose: *Duhet të përkujtohen viktimat e luftës*, etj. Por kur ndesh konstruktet, si: *Këto ishin viktima të pafajshme! Në luftën e Kosovës pati shumë viktima të pafajshme!* etj. (RTK) kjo nuk shkon. Konstruk-

tet e tilla janë gabim për arsye se vetë fjala "**viktimë**" përmban kuptimin e "pafajsisë". Viktimë të "fajshme" nuk ka. Të gjitha viktimat janë të pafajshme.

Edhe në **Fjalor** e gjejmë këtë shpjegim: **VIKTIMË-A** "*Ai që vdes a që lëndohet gjatë një aksidenti a fatëkeqësie natyrore, nga dikush, nga një luftë' etj. viktimat e tërmetit, 2 viktimë e agresionit. 2. ai që pëson pa të drejtë nga një veprim i gabuar , nga dikush që e mashtron, nga një qëndrim i caktuar etj. viktimë e vetëvetes, viktimë e një mirëbesimi; viktimë e dashurisë* (Fjalori i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 2006, f. 1188). Pra nëse themi "*viktimë e pafajshme*", është krejt njësoj sikur të themi "*Ujë i lagësht*"(!) (uji nuk mund të jetë i thatë, apo jo?!) apo "*akull i ftohtë*"(po ashtu as akulli nuk mund të jetë i ngrohtë!) etj.

Dhe krejt në fund vlen të përmendet se tani vonë, në në disa media tona, si në Top Channel, TVSH, etj, për fjalën "**thashetheme-t**", po përdoret një trajtë tjetër "thashethemnajë-a".Kjo fjalë, si formim krejt artificial, mendoj, se është e panevojshme. Është interesante se në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, Tiranë , 2006 (pra botimi i fundit) kjo fjalë del në formën "**thashethemanjë-a**", e jo "*thashethemnajë-a*", siç po dëgjohet në media. Ky mosstabilitet, ndoshta, dëshmon qartë se kjo fjalë vështirë po stabilizohet. Kjo divergjencë të bën të mendosh se kjo fjalë e re (edhe kështu si është) a është gabim në media "thashemnajë-a" apo në fjalor "thashethemanjë-a"?